



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 918/2 prot

Datë 16.04.2024

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr.REF-98973-03-20-2024, me objekt “*Blerje materiale mjekimi te pergjitheshme per nevoja te DSHSP MMI*”, me fond limit 3,184,409 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Trimed” SHPK me NIPT (K51612031J), me adresë: Autostrada “Tiranë – Durrës”, Km.10, Zonë kadastrale 2105, Nr.pasurie 95/11, Kashar, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec, me adresë: Lagjja Nr. 5, Rruga “Islam Dani”, Pogradec

Në datën 16.04.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, ka administruar ankesën me nr. A/2024/3971, dhe nr. Protokollit 918/2024, datë 16.04.2024, të operatorit ekonomik “Trimed” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr.REF-98973-03-20-2024, me objekt “*Blerje materiale mjekimi te pergjitheshme per nevoja te DSHSP MMI*”, me fond limit 3,184,409 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 02.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Pogradec.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:

b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Trimed” SHPK kundërshton me anë të ankesës nr. A/2024/3971, dhe nr. Protokollit 918/2024, datë 16.04.2024. Konkretisht për arsyet e skualifikimit si më poshtë:

*“Arsyet e s’kualifikimit të OE ofertues “TRIMED” Sh.p.k. me nr.nipt-i K51612031J për procedurën e prokurimit elektronik me objekt: Loti,”Blerje materiale mjekimi të pergjithshme për nevoja të DSHS Pogradec(MM1)\_ “Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik (një OE të vetëm fitues për secilin lot)- ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj) ,me nr. reference REF-98973-03-20-2024 paraqiten si më poshte:*

*I*

*Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ofertuesi “TRIMED” Sh.p.k. vihet re se për artikullin nr.117 në “Formularin e Ofertes”(listen e çmimeve) me emertimin “Ndricues oral” mungojnë:*

- Certifikata ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent ISO 13485 “Per Sistemin e menaxhimin të cilesise” /ose ekuivalent/ të vlefshme*
- Certifikata konformiteti CE , ose Certificate FDA ,*
- Prodhesi dhe vendi i prodhimit në katalog.*

*Pra bazuar sa më lart nga OE ofertues “TRIMED” Sh.p.k. me nr.nipt-i K51612031J nuk janë permbushur kriteret e vecanta sa më poshte:*

*Nuk është permbushur pika 2.1“Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë” , nën-pika 2.3.1,e DST-ve në të cilën citohet si vijon:*

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015 /ose/ ekuivalent ISO 13485 “Per Sistemin e menaxhimin të cilesise” /ose ekuivalent/ të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar, ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë vetëdeklarim ku të deklarohet se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë.*

*Nuk është permbushur pika 2.1“Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomikë” , nën-pika 2.1.3, e DST-ve në të cilën citohet si vijon:*

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE të vlefshme, ose Certificate FDA për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.*

*Nuk është permbushur pika 2.3, “Kapaciteti teknik”, nën-pika 2.3.5, e DST-ve në të cilën citohet si vijon:*

Kërkohen të paraqiten katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në [ëëë.app.gov.al](http://ëëë.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DST).

## II

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ofertuesi "TRIMED" Sh.p.k. vihet re se artikulli me nr.42 në "Formularin e Ofertes" (listen e cmimeve) me emertimin "Dren Silikoni" është deklaruar si vend prodhimi Indi, dhe prodhues "Sterimed Medical Devices Pvt. Ltd Nderkohe po i njejtë artikull nuk është paraqitur me të njejtin prodhues dhe vendprodhimi në katalog.

Ky artikull është deklaruar në katalog me prodhues "Yangzhou Super Union Import and Export Co.Ltd.Kine.Pra informacini në lidhje me prodhuesin dhe vendprodhimin nuk është i njejtë nëse krahesojmë katalogun me formularin e ofertes për këtë artikull.

Pra bazuar sa me lart OE ofertues "TRIMED" sh.p.k. nuk ka përmbyllur pika 2.3, Kapaciteti teknik, nën-pika 2.3.5, e DST-ve në të cilën citohet si vijon: Kërkohen të paraqiten katalogë teknike për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në [ëëë.app.gov.al](http://ëëë.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DST).

## III

Në listen e inventarizimit të mostrave të paraqitura nga OE "Trimed" pranë AK-se në datën 28.03.2024 ora 10:00 nuk janë plotësuar kolonat në lidhje me prodhuesin dhe vendin e prodhimit duke mos përmbyllur në këtë mënyrë pikën 2.3, "Kapaciteti teknik", nën-pika 2.3.6 në të cilën citohet si vijon:

Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar :

Dorezimi i kampioneve /mostrave të bëhet pranë Autoritetit kontraktor , të mbyllura me ngjyresë në kuti jo transparente të vulosura . mostrat do të dorëzohen pranë KVO-se me anë të një procesverbali të firmosur nga përfaqësuesi i operatorit ofertes dhe KVO-se, dy ditë përpara hapjes së procedurës ORA 10:00.

Mostrat e dorëzuara duhet të jenë të shoqëruara me listen e inventarizimit dhe të identifikuar sipas nr rendor të formularit të cmimit. Nëse ka mungesë mostrash për artikuj të vecantë ose nëse origjina e stampuar mbi mostër nuk përputhet me origjinën e deklaruar , atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

## IV

Nga verifikimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE nga ofertuesi "TRIMED" Sh.p.k. vihet re se specifikimet teknike në katalog (të perkthyer) për artikujt me nr.5, 17, 18, 20, 22, 24, 29, 33, 37, 39, 42, 43, 50, 96, 110, 111, 112, dhe 117 nuk përputhen saktësisht me specifikimet teknike të kërkuara në tabelën perkatese të DST-ve, duke mos përmbyllur në këtë mënyrë shtojcën 8 "Formulari përmbledhës i deklaramentit" në të cilën citohet se: Në cilësinë e operatorit ekonomik, në deklarimet se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin

*në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.”*

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 16.04.2024.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**